

Në këtë botim:

- Përfundimi me sukses i kurseve të biznesit – ndarja e mirenjohjeve dhe biznes planeve
- Takimi i dytë me komitetin drejtues
- Dita e grave rurale
- Takim me kryetarin e komunës të Gjilanit z. Qemajl Mustafa
- Vizitë studimore në Maqedoni – gratë fermere
- Lansimi i projektit : Sipërmarrja Femërore - Makineri krijuese për fronte pune në Evropën Jug Lindore 2012-2015

Supported by Ministry of Foreign Affairs of Denmark



SHOQATA AFARISTE E GRUAS

“MBËSHTETJE PËR GRATË SIPËRMARRËSE NË AGROKULTURË 2012-2015”

BULETIN

Numër 2, botimi 2 / Dhjetor/2012

PËRFUNDIMI ME SUKSES I KURSEVE TË BIZNESIT – NNDARJA E MIRENJOHJEVE DHE BIZNES PLANEVE

Qershor-Dhjetor, 2012



Në periudhën rajonin e Gjilanit janë mbajtur trajnimet në këto zona: Komuna e Gjilanit (fshati Dobërzan, Përlepnice), Komuna e Kamenicës (fshati Roganë), Komuna e Vitis si dhe përfituese të kursit ishte grupi i vajzave nga Shkolla e Mesme e Bujqësisë “Arbëria” në Gjilan. Ndërsa në rajonin e Gjakovës janë mbajtur trajnimet në këto zona: Komuna e Gjakovës (fshati Cërmjan, Rracaj, Molliq dhe Novosell) si dhe Komuna e Malishevës (Banja e Malisheves, Kijevë, Terpezë, Lubishte, Turjakë, Vermicë, Mleqan, Drenovc, Mirusha and Marali).

Pas përfundimit me sukses të kurseve të biznesit të mbajtur nga stafi i SHE-ERA-së, janë ndarë mirënjohje për 122 përfituese gra dhe vajza fermere të regjionit të Gjakovës dhe 141 përfituese nga rajoni i Gjilanit. Gratë dhe vajzat fermere përfituese të këtyre dy regjioneve të cilat me sukses ndjekën nëntë modulet “Si të Fillojmë një Biznes të Suksesshëm”, zhvilluan idet e tyre individuale dhe hartuan biznes planet e tyre grupore gjatë kursit ku secili grup e ndjekë një muaj me nga pesë orë në ditë. si rezultat i kurseve të mbajtura në këto dy rajone janë shpërndarë gjithsej 245 biznes plane (43 biznes plane grupore dhe 202 biznes plane individuale). SHE-ERA do të vazhdojë prej muajit Janar 2013, duke vazhduar mbajtjen e kurseve dhe ofrimin e shërbimeve të tjera për ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të grave fermere, fuqizimin e tyre ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës në të dy regjionet e para të planifikuara 2012-2013, Gjilan dhe Gajkovë. Përfituese të këtyre dy regjioneve do të jenë edhe 225 gra dhe vajza fermere.

SHE-ERA në kuadër të projektit “Mbështetje Grave Sipërmarrëse në Agrokulturë”, gjatë kësaj periudhe orfojë këshilla për 31 gra sipërmarrëse në agrokulturë në regjionin e Gjakovës, të cilat merren me përpunimin e qumshit, bletari dhe kultivimin e pemëve dhe perimeve. Këshillat i’u ofruan për ngritjen e kapaciteteve të tyre në marketing për plasimin sa më të mirë të produkteve të tyre në treg.

www.she-era.org

TAKIMI I DYTË ME KOMITETIN DREJTUES

Shator 2012,

Takimi i dytë i radhës me Komitetin Drejtues i përbër me përfaqësues nga: Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (Mikael Erbs), MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Nysrete Doda), Oda Ekonomike e Kosovës (Safet Gërxhaliu), OJQ vendore “Drita e Krushes” (Ola Sylja) dhe “CB Mitrovica” (Afërdita Sylja), u mbajtë në muajin Shtator, ku u diskutuan këto pika: Raporti gjashtëmujorë i progresit, Plani strategjik 2012-2016, Plani i punës dhe aktivitetet përcjellëse të vitit 2012, Buxheti i vitit 2012, dhe krijimi i të dhënave të grave në agrokulturë – rritja e numrit të anëtarëve të reja me pagesë - gra fermere në SHE-ERA.

Drejtoresha Ekzekutive Kusari-Purrini për projektin “Mbështetje Grave Sipërmarrëse në Agrokulturë”, informojë anëtarët e KD, për ecurin e projektit, aktivitetet e realizuar deri më tani, sfidat gjatë realizimit të projektit dhe tejkallimet e tyre si dhe rezultatet e pritshme për periudhën punuese pas takimit të parë të Komitetit Drejtues. Gjithashtu u diskutua për secilën pikë të agjendës, dhe u dhanë komente nga anëtarët e komitetit drejtues për punën në vazhdim. Komiteti Drejtues dha si përfundim se fazat e projektit “Mbështetja e Grave Sipërmarrëse në Agrokulturë” kishte rrjedhjen e saj të planifikuar, duke shprehur gatishmërinë që të kontribuojnë për të mbështetur projektin në fazat tjera.



DITA E GRAVE RURALE

Dhjetor 2012,



cilat përballesh gratë fermere për çdo ditë. U diskutuan strategji praktike të cilat gratë fermere mund t'i shfrytëzojnë për të përfituar nga skemat e granteve qeveritare dhe skemat tjera të cilët ofrohen nga partnerët e tjerë zhvillimorë, vendorë dhe ndërkombëtar. Interesimi i grave ishte i lartë ku këtë e dëshmojë edhe prezenca e tyre në “Ditët e Grave Rurale”, gjithsejtë të pranishëm ishin 300 pjesëmarrës ku 274 ishin gra fermere të regjionit të Kosovës.

SHE-ERA, gjatë prezentimit të saj informojë audiencën e gjerë për projektin “Mbështetje Grave Sipërmarrëse në Agrokulturë 2012-2015” në katër regjionet e Kosovës (Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Pejë), mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës, ku përfituese do të jenë 1440 gra dhe vajza fermere.

Në fund të ditës u mbajtë ceremonia e dhënies së grantit për gruan më të mirë fermere për vitin 2012, në dy sektorë atë të përpunimit dhe kultivimit. Në sektorin e përpunimit të perimeve, Selvete Fetahu - Komuna e Podujevës, ndërsa në sektorin e Kultivimit Vlora Xhemajli -Komuna e Gjakovës, u shpërblyen nga SHE-ERA me ndihmën e UNDP'së me nga 5000 Euro grant investivë si dhe në bashkëpunim me MBPZHR, USAID.

Për herë të parë në Kosovë në muajin Dhjetor 2012, gratë fermere gëzuan ditën e tyre. Manifestimi “Dita e Gruas Fermere”, iniciativë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), me mbështetje nga USAID, UNDP dhe SHE-ERA, kishte për qëllim krijimin e mundësive për gratë e suksesshme fermere, u shqyrtuan modele dhe mënyra të sektorëve të ndryshëm për gjetjen e mundësive të përbashkëta dhe tejkallimit të sfidave në zhvillimin e bujqësisë dhe fuqizimin ekonomik të gruas. Problemet me të cilat përballesh gratë fermere mes tjerash janë: qasja e kufizuar në tokë, qasja në financa, shkollimi, shërbimet e ekstensionit si dhe shërbimet tjera mbështetëse.

U diskutuan mënyrat se si të trajtohen, tejkallohen dhe menaxhohen në të ardhmen disa nga sfidat me të

TAKIM ME KRYETARIN E KOMUNËS TË GJILANIT Z. QEMAJL MUSTAFA

Nëntor 2012,

Takimi me Kryetarin e Komunës së Gjilanit Z. Mustafa dhe Drejtoreshës Ekzekutive të SHE-ERA's Zj. Kusari Purrini, kishte për qëllim informimin e Kryetarit me aktivitetet në vazhdimësi të cilat po zhvillohen në regjionin e Gjilanit nga SHE-ERA, në kuadër të projektit “Mbështetje Grave Sipërmarrëse në Agrokulturë”, përkrahur Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës. Zj. Kusari Purrini tregoi planet dhe të arriturat deri tani në regjionin e Gjilanit duke theksuar se përfutuese të trajnimeve dhe këshillave të ofruara deri më tani janë 117 gra dhe vajza fermere nga zonat rurale të këtij regjioni. Z.Qemajli u informua edhe për idet e biznes planeve individuale dhe grupe të grave sipërmarrëse në agrokulturë, projekte investive të hartuara nga vetë gratë fermere të regjionit të Gjilanit për të cilat u kërkua nga Z.Qemajli që të shikojë mundësit e bashkë-financimit nga skemat e granteve buxhetore komunale për të kontribuar në hapjen e vendeve të reja të punës dhe fuqizimin e grave në agrokulturë.

Z. Mustafa, tregoi gatishmërinë për mbështetjen e planit në veprim të Shoqatës Afariste të Gruas SHE-ERA, dhe mundësive të mbështetjes së projekteve investive të grave në agrokulturë përmes skemave të ndryshme financiare në disponim si nga ana e buxhetit komunal ashtu edhe partnerëve të tjerë zhvillimorë në regjionin e Gjilanit. Prezente në takim ishte edhe Deputetja në Asamblen Komunale Zj.Shkodra, e cila në emër të grupit të grave deputete shprehi gatishmërinë e tyre për të ndihmuar dhe integruar gratë e zonave rurale në jetën ekonomike, politike, kulturore dhe sociale.



VIZITË STUDIMORE NË MAQEDONI – GRATË FERMERE

Nëntor 2012,

SHE-ERA përmes vizitës studimore në Maqedoni, “Transferimi i Njohurive në Sektorin Rural” të organizuar nga MBPZHR dhe në mbështetje të Bankës Botërore, i'u mundësojë 6 grave përfutuese të projektit “Mbështetje Grave Sipërmarrëse në Agrokulturë 2012-2015”, që të jenë pjesë e grupit dhe të mësojnë nga përvojat e prodhuesve dhe përpunuesve të tjerë në rajon, duke u njoftuar për së afërmi me problemet dhe sfidat që përballen vendet tjera të rajonit. Nëpërmjet kësaj vizite fermeret patën mundësi të shohin dhe të kuptojnë se si funksionojnë shërbimet e sektorit të agrokulturës në Maqedoni, përmirësimin dhe menaxhimin e zingjirit të furnizimit me fruta dhe perime, teknikat e prodhimit, veçanërisht prodhimin në sera, mbledhjen e frutave dhe perimeve, menaxhimin e qendrave të grumbullimit dhe teknologjitë e zbatuara në përpunimin e frutave dhe perimeve.

Vizita studimore zgjati 3 ditë, prej datës 21-23 Nëntor 2012, përfutuese të kësaj vizite ishin gratë e të dy regjioneve Gjilan dhe Gjakovë. Gratë pas vizitës u shprehën mjaft të kënaqura dhe ndiheshin me fat që ishin pjesë e saj duke patur mundësin që të shohin për së afërmi organizimin e disa pikave grumbulluese të frutave dhe perimeve, procesimin e frutave dhe perimeve në Shkup, Strumnice, Gjevgjeli si dhe sera të ndryshme dhe fabrikën e verarisë në Kavadarre.

Këtë vizitë, gratë e konsideruan mjaft të rëndësishme edhe për shkëmbimin e kontakteve dhe mundësive të bashkëpunimit me fermer të suksesshëm në fusha të ndryshme të agrokulturës jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon.



LANSIMI I PROJEKTIT :

Sipërmarrja Femërore - Makineri krijuese për fronte pune në Evropën Jug Lindore 2012-2015

Tetor, 2012

Rrjeti i Grave “Millenium”, promovojë fillimin e projektit ku përfshihen këto shtete: Shqipëria, Bosnja&Hercegovina, Kroacia, Kosova, Moldavia, Serbia, Mali i Zi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia: “Sipërmarrja Femërore - Makinë për

Krijimin e Vendeve të Punës në Evropën Jug-Lindore, mbështetur nga Mbretëria e Suedis. Prezentuese në takim ishin: Mary Ann Rukavina Ceptiq - Drejtoreshë Ekzekutive e Gender Task Force, Ingrid Johansson - Mbretëria e Suedisë, Teuta Sahatqija – Grupi i Grave Deputete në Parlamentin e Kosovës, Mirlinda Kusari Purrini- Drejtoreshë Ekzekutive në SHE-ERA, Vjolla Kuqi - Rrejt



Qeliza.

Qëllim i projektit është promovimi i grave sipërmarrëse në Evropën Jug-Lindore nëpërmjet përpjekjeve të kombinuara mes sektorit publik dhe privat. Nxitja e praktikave më të mira në përputhje me Aktin e Bizneseve të Vogla për Evropë, dhe ndërtimin e kapaciteteve të rrjeteve kombëtare dhe rajonale të grave sipërmarrëse dhe shoqatave. Gratë sipërmarrësit në Evropën Juglindore do të përfitojnë direkt nga ky projekt me qëllim të përmirësimit të mjedisit për të bërë biznes, kuadrit ligjor dhe politikat fiskale. Rezultati pritur i projektit është:

-Ngritja e vetëdijes dhe inicimi i dialogut për politika të avancuar në

kuadrin e politikave të ndërmarrësisë së grave në përputhje me parimet relevante të Aktit të Bizneseve të Vogla.

- Kapacitetet e zgjeruara të rrjeteve të grave sipërmarrëse dhe shoqatave.

Gratë Sipërmarrëse në EJK janë përfitueset më të drejtpërdrejta të projektit, ato do të fitojnë dobi të drejtpërdrejta nga politika e përmirësuar dhe veprimet e ndërmarra. Ato janë pjesëmarrës në projekt nëpërmjet rrjeteve të biznesit dhe shoqatave dhe ekspertizave të ofruara.

LINKU I GRAVË NDËRMARRËSË NE AGROKULTURE

SHE-ERA ka freskuar web-faqen e saj të internetit për ta kthyer atë në një mjetë efektiv, ku nëpërmjet krijimit të hapësirës SHE-ERA, do të ju mundësojë anëtarëve të saja të promovojnë punën e tyre dhe të krijojnë partneritet me akterë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtar, komunitetin e biznesit, partnerë zhvillimorë dhe bashkëveprimin në mes të anëtarëve të SHE-ERA's dhe grave afariste jashtë vendit.

Në faqen e internetit është krijuar baza e të dhënave për anëtarët e SHE-ERA (<http://www.she-era.org/antaret.php>) dhe për Gratë Sipërmarrëse në Agrokulturë (<http://www.she-era.org/mod.php?mid=31>), ku përfshihen të dhënat e grave fermere. Me anë të këtij link-u ato do të përfitojnë ndihmesë të madhe për realizimin e përpjekjeve të tyre, do të vihen në dukje kapacitetet e tyre si gra sipërmarrëse dhe do të kenë mundësinë e bashkëpunimit me programet vendore dhe ndërkombëtare dhe agjensive të fokusuar në fuqizimin ekonomik të grave.

EKIPI I SHE-ERA s

STAFI I SHE-ERAs

Mirlinda Kusari-Purrini - Drejtore Ekzekutive
Ardiana Qela - Menaxhere e Projektit
Ymrane Nura - Administratore/Financa
Zana Rizvanolli - Koordinatorë e Trajnimeve
Edita Axhemi - Asistente e Trajnimeve
Vjollca Salihu - Trajnere (Rajoni i Gjilanit)
Linda Kosumi - Asistente (Rajoni i Gjilanit)
Bujar Haxhibeqiri - Vozitës & logjistikë

ANËTARËT E BORDIT TËSHE-ERA s

Xheraldina Vula - Kryetare e bordit
Justina Shiroka Pula
Lulzim Çela
Luljeta Vuniqi
Burbuqe Berisha

ANËTARE NDERI

Naxhije Buqinca

KËSHILLTAR TË LARTË PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE DHE GJINORE

Glynis Long
Jocelyne Talbot

SHOQATA AFARISTE E GRUAS SHE-ERA

Rr. Ismail Qemajli nr.9 (Çarshija e Jupave)

Tel: +381 (0) 390 323 194

Fax: +381 (0) 390 323 194

Email: wsheera@gmail.com

www.she-era.org